



# **Ndryshimet e reja në Skeletkurrikulën e drejtimit mësuesor “BUJQËSI”, Niveli II I KSHK**

**Albina Buci – AKAFPK  
Tiranë, 17 shtator 2022**

Slido.com

Kodi: **3470226**

# Fazat e rishikimit të Skeletkurrikulës “BUJQËSI”, Niv. II i KSHK



## Skeletkurrikuli i drejtimit “Bujqësi”, Niv. II i KSHK (2 vjeçar) zbatohet vetëm klasa 10.

- **Kompetencat profesionale** janë plotësuar me aftësi që kanë të bëjnë me:
  - përdorimin e burimeve të informacionit dhe platformave dixhitale.
  - komunikimin me etikë dhe profesionalizëm.
  - zbatimin e rregullave të sigurisë në punë, të mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me standardin e rishikuar të kualifikimit.

# Lëndët profesionale

- **Lënda “Bazat e bujqësisë”, kl.10 me 3 orë/javë:**
  - riformuluar synimet e lëndës,
  - ndryshime përmbajtësore duke u shtuar tema të reja.
- **Ndërsa në kl.11, me 1 orë/javë:**
  - ndryshime përmbajtësore, duke shtuar tema të reja që kanë të bëjnë me:
    - (i) praktikat e mira bujqësore,
    - (ii) përdorimin e TIK në bujqësi,
    - (iii) mënyrat e vjeljes dhe proceset e pasvjeljes së kulturave bujqësore.

- **Lëndët “Mbarështim kafshësh bujqësore” kl.10 dhe 11, “Zoo higjienë” kl.11, “Perime dhe lule” kl.10, “Bimët e arave” kl.10, “Pemët frutore” kl.11 dhe “Makinat bujqësore” kl.11,** hiqen nga plani mësimor dhe nuk do të trajtohen.
- **Lënda “Bazat e blegtorisë” kl.10 dhe 11,** është lëndë e re, ku janë integruar përmbajtje mësimore që kanë të bëjnë me mbarështimin e kafshëve, higjienën e kafshëve, të ushqyerit, përdorimin e TIK në blegtori, njohuri të thjeshta kirurgjikale.

# Modulet profesionale:

- **Moduli “Marrja e mostrës së tokës për analizë” kl.10 me 36 orë mësimore**, ka pësuar përmirësime përmbajtësore.
- **Moduli “Përgatitja e shtretërve për mbjelljen e farave të imëta” kl.10 me 54 orë** bashkohet me **Modulin “Prodhimi i fidanëve të kulturave perimore” kl. 10 me 54 orë**. Në këtë modul është shtuar edhe shartimi i kulturave perimore.
- **Moduli “Kultivimi i bimëve të arave” kl.10 me 54 orë**, është i ri.
- **Moduli “Të ushqyerit në blegtori”** është modul i ri dhe zhvillohet në kl.10 me 36 orë.

- **Moduli “Përdorimi i veglave të dorës në bujqësi” kl.11** me 69 orë hiqet nga plani mësimor dhe nuk do të trajtohet.
- **Moduli “Prodhimi i fidanëve të kulturave drufrutore” kl.11** me 102 orë, është modul i ri.
- **Modulet “Mirëmbajtja e makinave bujqësore” kl.11 me 51 orë, si dhe “Përpunimi i thjeshtë i prodhimit foragjer” kl.11 me 51 orë,** janë rishikuar dhe kanë pakësim të orëve mësimore.



- **Moduli “Mjelja e kafshëve bujqësore”** bëhet modul i detyruar në kl.11 dhe ka pakësim orësh, nga 68 orë, në 51 orë mësimore.
- **Moduli “Kujdesi për kafshët bujqësore” kl.11** bëhet me 85 orë dhe ka pësuar përmirësime përmbajtësore.
- **Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar “Rritja e krimbit të mëndafshit dhe e kërmillit”, “Përpunimi i mbetjeve organike” dhe “Kultivimi i bimëve aromatike dhe mjekësore”,** në kl.10 me nga 36 orë secili, janë module të reja.

- **Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar “Mbarështimi i lepujve”, “Mbarështimi i shpendëve shtëpiakë” kl.11 me nga 34 orë secili, janë module të reja.**
- **Moduli i e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar “Mbjellja e fidanit të hardhisë”, ka pakësim orësh, nga 68 orë, në 34 orë.**
- **Moduli i e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar “Shtimi me copa i kulturave bujqësore”, ka ndryshim të titullit, rishikim të përmbajtjes dhe pakësim orësh (bazuar te moduli i mëparshëm “Shtimi me copa i drufrutorëve”).**

# Kurrikula shkollore përbëhet nga:

a

- **“Plani mësimor operativ”**, i cili hartohet bazuar në tabelën e “planit mësimor” që jepet në skeletkurrikulin e kualifikimit profesional përkatës;

b

- **“Planet e mësimdhënies” së lëndëve teorike profesionale**, të cilat hartohen nga mësuesit përkatës nën drejtimin e Koordinatorit të Kurrikulave, bazuar në “programet e përgjithshme të lëndëve profesionale” përkatëse (të përfshira në skeletkurrikul);

c

- **“Planet e mësimdhënies” së moduleve praktike profesionale** të cilat hartohen nga mësuesit e praktikës (instructorët) përkatës nën drejtimin e Koordinatorit të Kurrikulave, bazuar në “përshkruesit e moduleve profesionale” (të përfshira në skeletkurrikul).

d

- **“Programet e praktikës profesionale në biznes”**, të cilat hartohen nga mësuesit e praktikës profesionale nën drejtimin e Koordinatorit të Kurrikulave dhe në bashkëpunim me përfaqësuesin (instructorin) e biznesit përkatës.

Slido.com

**2452810**